

## **PYETJE TË SHPESHTA**

- 1. A disponon AMA ndonjë material informues mbi lidhjen e dekoderave DVB-T2 me televizorin dhe informacione të tjera të nevojshme për procesin e digjitalizimit?*

Të gjitha këto informacione do t'i gjeni të ilustruara në Broshurën që AMA ka përgatitur që në fillim të procesit, të cilën mund ta gjeni në faqen zyrtare të AMA-s. link:

[http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2016/04/Broshura\\_AMA\\_Dixhitalizimi.pdf](http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2016/04/Broshura_AMA_Dixhitalizimi.pdf)

- 2. Çfarë duhet të bëj në mënyrë që të kem sinjal digjital në televizorin tim?*

Për të aksesuar sinjalin digjital duhet të pajiseni me një dekoder të jashtëm Universal DVB-T2 ose një televizor i cili të ketë të inkorporuar këtë tip dekoderi. Në rastin e dekoderit të jashtëm, sigurohuni që lidhja e tij me televizorin dhe antenën të jetë kryer në rregull dhe më pas vendosni televizorin tuaj në kërkim automatik, për të gjetur kanalet digjitale. Nëse dekoderi është i inkorporuar në televizor, mjafton të lidhni televizorin me antenën dhe më pas t'a vendosni në kërkim automatik.

- 3. Nëse nuk pajisem me dekoder, çfarë ndodh?*

Nëse aktualisht aksesoni transmetimet televizive nëpërmjet teknologjise tokësore analoge, me mbylljen e këtyre transmetimeve, nëse ju nuk pajiseni me dekoder apo televizori juaj nuk ka të inkorporuar dekoderin e tipit DVB-T2, atëherë ju nuk do të mund të shikoni më televizor. Sqarojmë se procesi i digjitalizimit do të ndodhë në të gjithë Shqipërinë. Transmetimet tokësore analoge do të mbyllën dhe do të kalohet në transmetimet tokësore digjitale.

- 4. Cilin dekoder duhet të blej, pasi në treg ka shume lloje?*

Markat e prodhimit të dekoderave mund të jenë të ndryshme por e rëndësishme është që tipi i dekoderit të jetë Universal DVB-T2, në mënyrë që të përdorni një dekoder për të gjitha platformat numerike.

- 5. Në çfarë formati dhe rezolucioni duhet ta kem televizorin që të kem mundësi të ndjek transmetimet digjitale?*

Për të aksesuar transmetimet digjitale nuk ka rëndësi se çfarë parametrash ka televizori juaj. E domosdoshme është që të pajiseni me një dekoder të jashtëm Universal DVB-T2, ose një televizor i cili të ketë të inkorporuar këtë tip dekoderi.

- 6. Cila është lista e kanaleve televizive që do të ofrohet pas kalimit në transmetimet digjitale?*

Lista e kanaleve është në varësi të qarkut ku ju banoni. Kanalet e lira (pa pagesë) që mund të shikohen do të jenë të gjithë kanalet e operatorëve kombëtarë (RTSH-së dhe operatorëve private), si dhe kanalet lokale/rajonale që më parë transmetonin në analog në qarkun tuaj.

*7. A duhet të paguajë për të parë transmetimet digjitale?*

Transmetimet digjitale ofrohen pa pagesë dhe me pagesë. Kanale të lira (pa pagesë) do të jenë të gjithë kanalet e operatorëve kombëtarë (RTSH-së dhe operatorëve privat) si dhe kanalet lokalë/rajonale që më parë transmetonin në analog në qarkun tuaj. Ndërkohë platformat numerike private ofrojnë edhe paketa televizive kundrejt pagesës.

*8. A duhet të pajisem me antenë të re apo antenë satelitore?*

Digjitalizimi i transmetimeve televizive lidhet vetëm me transmetimet tokësore dhe jo ato satelitore, kabllore apo shërbimet audiovizive të mbështetura në internet (IPTV, OTT, etj). Për të aksesuar këto transmetime mund të provoni të përdorni antenën që keni pasur në përdorim për transmetimet analoge, pa pasur nevojë të blini një antenë tjetër. Ndërkohë për të patur një sinjal të mirë televizivë antena juaj duhet të drejtohet nga pika e transmetimit më e afërt me vendndodhjen tuaj.

*9. Unë kam një televizor me dekoder DVB-T2 të integruar. Çfarë duhet të bëj që të shikoj transmetimet digjitale?*

Televizorin tuaj duhet t'a lidhni me antenën dhe më pas vendoseni në kërkim automatik për të gjetur kanalet digjitale. Duhet të keni parasysh se, ndryshe nga transmetimet analoge, ku antena mund edhe të jetë drejtuar jo plotësisht nga pika e transmetimit, për transmetimet digjitale drejtimi i antenës ka shumë rëndësi, pasi ndikon drejtpërsëdrejti në marrjen e sinjalit dhe cilësinë e tij.

*10. A nevojitet që çdo televizor në shtëpi të pajiset me dekoder (DVB-T2) më vete?*

Nëse televizori e ka të inkorporuar dekoderin DVB-T2 nuk është e nevojshme të blini dekoder të jashtëm. Në të kundërt çdo televizor duhet të pajiset me dekoder të jashtëm. Ofrohet edhe mundësia që të keni një dekoder të vetëm dhe me një ndarës (spliter) sinjali digjital të shpërndahet tek televizorët e tjerë, por në këtë rast tek të gjithë televizorët do të shihet i njëjti kanal televiziv. Pra nuk është mundësia që në televizor të ndryshëm të shihen kanale të ndryshme televizive.

*11. Nëse unë e lidh televizorin me një dekoder të jashtëm DVB-T2, a duhet ti ruaj vetë të gjitha kanalet?*

Nëse e vendosni në kërkim automatik televizorin tuaj atëherë kanalet televizive digjitale do ju renditen sipas përcaktimeve të AMA-s. Ndërkohë ju jepet mundësia që t'i rendisni kanalet sipas dëshirës.

*12. Ku mund ta blej dekoderin?*

Dekoderi mund të gjendet në pikat e shitjes ku tregtohen pajisje televizive si antena, kablllo televiziv, antena satelitore etj. Vetëm duhet të bëni kujdes që dekoderi të jetë i tipit universal DVB-T2, në mënyrë që të përdorni një dekoder për të gjitha platformat numerike.

*13. Si ta lidh dekoderin me televizorin?*

Mënyra e lidhjes së dekoderit me televizorin dhe antenën është shumë e thjeshtë dhe e pagabueshme. Lutem ndiqni udhëzimet e manualit që ndodhet në kutinë e dekoderit.

*14. Sa kushton një dekoder i tipit DVB-T2?*

Çmimi dekoderit varion sipas llojit, markës apo vitit të prodhimit. Por, AMA nuk e disponon një informacion të tillë, pasi AMA nuk ka autoritetin për të kontrolluar dhe verifikuar çmimin e dekoderave në treg.

*15. Pse duhet ta blej dekoderin dhe te mos e përfitoj falas atë?*

Qeveria ka vendosur të sigurojë falas (të subvencionojë) dekoderin vetëm për familjet të cilat bëjnë pjesë në skemën e ndihmës ekonomike të ofruar nga shteti. Aktualisht janë shpërndarë 80 mijë dekodera falas në të gjithë Shqipërinë.